

Drejtuar: Operatorit ekonomik “V.A.S. Konstruksion” shpk

Adresa: Rruga "Andon Zako Çajupi", Qendra Zayed Bussiness Center, seksioni 3 C,
D, kati III-të, Tiranë.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Ndërtim pedonale dhe korsi biçikletash në Liqenin e Thatë”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Ndërtim pedonale dhe korsi biçikletash në Liqenin e Thatë”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-08201-10-14-2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Fondi limit: 69,600,572 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2021, miratuar me VKB Nr. 172, datë 21.12.2020 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2021”.

Kohëzgjatja e kontratës: 6 (gjashtë) muaj kalendarik duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 01.11.2021, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.151 datë 18.10.2021.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Albavia” shpk

NUIS J81527001Q

Vlera e ofertës = 41,571,091 (dyzetë e një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “Beqiri” shpk

NUIS J98624801V

Vlera e ofertës: **46,289,486.30** (dyzetë e gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë pike tridhjetë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Nika” shpk

NUIS J76705047U

Vlera e ofertës = **47,310,273** (dyzetë e shtatë milion e treqind e dhjetë mijë e dyqind e shatatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “Besta” shpk

NUIS J62903182B

Vlera e ofertës = **47,466,691** (dyzetë e shtatë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk

NUIS K11507003S

Vlera e ofertës = **48,620,599.13** (dyzetë e tetë milion e gjashtëqind e njëzetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë trembëdhjetë) lekë pa TVSH.

6. Operatori ekonomik “V.A.S. Konstruksion” shpk

NUIS L61322023P

Vlera e ofertës = **48,987,046.50** (dyzetë e tetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyzetë e gjashtë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

7. Operatori ekonomik “Kupa” shpk

NUIS K51615512C

Vlera e ofertës = **49,469,569** (dyzetë e nëntë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

8. Operatori ekonomik “Pepa Group” shpk

NUIS L42215009L

Vlera e ofertës = **49,930,837.43** (dyzetë e nëntë milion e nëntëqind e tridhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë pikë dyzetë e tre) lekë pa TVSH.

9. Operatori ekonomik “Glavenica” shpk

NUIS K17710805A

Vlera e ofertës = **50,786,516** (pesëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

**10. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “K. Turja” shpk & “Infinit” shpk
NUIS K81314014A & NUIS J74304623M**

Vlera e ofertës = **50,852,912.30** (pesëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e dymbëdhjetë pikë tridhjetë) lekë pa TVSH.

**11. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Shendelli” shpk & “NG Structures” shpk
NUIS K07924803N & NUIS I79326502O**

Vlera e ofertës = **52,559,409** (pesëdhjetë e dy milion e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e nëntë) lekë pa TVSH.

12. Operatori ekonomik “Albtiefbau” shpk NUIS J66307049C

Vlera e ofertës = **54,270,089** (pesëdhjetë e katër milion e dyqind e shtatëdhjetë mijë e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

13. Operatori ekonomik “Ina” shpk NUIS J61814009W

Vlera e ofertës = **56,334,209** (pesëdhjetë e gjashtë milion e treqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e nëntë) lekë pa TVSH.

14. Operatori ekonomik “Liqeni VII” sha NUIS K01730502W

Vlera e ofertës = **56,679,797.06** (pesëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë zero gjashtë) lekë pa TVSH.

15. Operatori ekonomik “Ante Group” shpk NUIS J62904100D

Vlera e ofertës = **59,316,177** (pesëdhjetë e nëntë milion e treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

16. Operatori ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk NUIS K02017003I

Vlera e ofertës = **59,712,844** (pesëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e dymbëdhjetë mijë e tetëqind e dyzetë e katër) lekë pa TVSH.

17. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Sterkaj” shpk & “Arjeil” shpk
NUIS J68310708M & NUIS K31320002C

Vlera e ofertës = **60,048,870** (gjashtëdhjetë milion e dyzetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

18. Operatori ekonomik “Inerti” shpk NUIS J66926804L

Vlera e ofertës = **61,095,864.27** (gjashtëdhjetë e një milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër pikë njëzetë e shtatë) lekë pa TVSH.

19. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Isec” shpk & “Arkon Studio” shpk
NUIS L41309004L & NUIS L42019004I

Vlera e ofertës = **61,485,690** (gjashtëdhjetë e një milion e katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

20. Operatori ekonomik “BE-IS” shpk NUIS K71412003A

Vlera e ofertës = **61,954,260** (gjashtëdhjetë e një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

21. Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk

NUIS K02003001O

Vlera e ofertës = **62,605,317** (gjashtëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e pesë mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

22. Operatori ekonomik “Delia Group” shpk

NUIS J81517002U

Vlera e ofertës = **64,490,288.10** (gjashtëdhjetë e katër milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë pikë dhjetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “Besta” shpk

NUIS J62903182B

- Në mbështetje të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 93, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu X, Neni 82, pika 4, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, referuar formulës së përcaktuar në dokumentat e tenderit, verifikoi nëse ofertat e vlefshme janë me çmim Anomalisht të Ulët nga ku rezultoi se oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Besta” shpk është në kushtet e Ofertës Anomalisht të Ulët.
- Për sa më sipër, KVO-ja për shkak të konstatimit të ofertës së paraqitur nga Operatori ekonomik si anomalisht të ulët, në mbështetje të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 93, pika 1, më datë 05.11.2021, nëpërmjet sistemit elektronik të vënë në dispozicion nga APP-ja i kërkoi Operatorit ekonomik të dërgojë me shkrim brenda datës 10.11.2021 ora 10:00, shpjegime për elementët e ofertës, në lidhje me zërat e preventivit të ofertës së paraqitur në tender, për të cilat kërkohet analizë kosto. Në rast të mosparaqitjes së këtij informacioni brenda datës 10.11.2021 ora 10:00, oferta e shoqërisë do të konsiderohej e papranueshme.
- Operatori ekonomik “Besta” shpk nuk ka paraqitur analizë kosto për çmimet e paraqitura në kushtet e ofertës anomalisht të ulët, çka bie në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu X, Neni 82, pika 4 ku ndër të tjera parashikohet se: “...*Ne cdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e vecanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e Nenit 93, të LPP-se*”.

2. Operatori ekonomik “Albavia” shpk

NUIS J81527001Q

- Operatori ekonomik nuk ka plotësuar kërkesat sipas shtojces 8, formularit permbledhes të vetdeklarimit pjesa II, deklarata A paragrafi i 3 ku specifikohet personat nën çilesinë e anetarit të organit administrative, drejtorit etj..... *nuk janë te*

denuar me vendim gjyqesor te formes se prere Plotesuar gabim adresa ueb-it, organi leshues dhe lloji i dokumentit.

- Operatori ekonomik nuk ka plotesuar kerkesat sipas shtojces 8, formularit permbledhes te vetdeklarimit pjesa II, deklarata B, Deklarata per Dorezimin e Ofertave te Pavarura pikat 8,9,10 Plotesuar gabim pergjigjet.
- Komisioni i Vleresimit te Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqerues te paraqitur nga Operatori ekonomik, konstatoi se nuk ka paraqitur ISO 50001-2011, cka bie ne kundershtrim me DST, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 10, germa “d”.

3. Operatori ekonomik “Beqiri” shpk

NUIS J98624801V

- Komisioni i Vleresimit te Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqerues te paraqitur nga Operatori ekonomik, konstatoi se ISO 50001-2011 nuk është e vlefshme, pasi ka skaduar me date 21.08.2021, cka bie ne kundershtrim me DST, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 10, germa “d”.

4. Operatori ekonomik “Nika” shpk

NUIS J7605047U

- Referuar Shtojcës 8, Operatori ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) minieskavator, çka bie ne kundershtrim me DST, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 11, ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet te disponoje 2 (dy) minieskavator me goma”.
- Referuar Shtojcës 8, Operatori ekonomik ka deklaruar se ndër të tjera disponon mjetet me targa AJMT55 dhe AA 932 XI. Pas verifikimeve rezultoi se mjetet e sipercituara jane te deklaruar ne proceduren e prokurimit me objekt: “*Parku i liqenit të Farkës një Pol Rekreativ për Tiranën*”, per te cilin eshte shpallur fitues., çka bie ne kundershtrim me DST, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 11, germa “g”.

5. Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk

NUIS K11507003S

- Për të vërtetuar përvojën e suksesshme Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk ka paraqitur si punë të ngjashme objektet si më poshtë vijon:
 1. Sistemim asfaltim Rruga e Rezervave Halil me vlerë 10,304,495 lekë pa TVSH;
 2. Mbyllje kanali me vlerë 5,691,865 lekë pa TVSH;
 3. Rikonstruksion i Rrugës “Kadri Kërçiku” me vlerë 25,214,044 lekë pa TVSH;
 4. Sistemim asfaltim i rrugës Hasrameve & KUZ me vlerë 19,669,418 lekë pa TVSH;
 5. Ndërtim Klenje, Fajza me vlerë 16,939,862 lekë pa TVSH;
 6. Ndërtim rrjeti TM 20 KW per furnizimin e kabines se re Tip Box Xhamia Popullore) me vlerë 10,981,659 lekë pa TVSH (referuar Preventivit të Punimeve dhe Situacionit përfundimtar nuk konsiderohet punë e ngjashme, pasi nuk i përket infrastrukturës rrugore);
 7. Rikonstruksion i pesë Godinave ekzistuese dhe ndertimi i sistemit te ngrohjes ne QKP, Azilkerkuesit Berat me vlerë 61,986,806 lekë pa TVSH (referuar Preventivit të Punimeve dhe Situacionit përfundimtar nuk konsiderohet punë e ngjashme, pasi nuk i përket infrastrukturës rrugore).

Për sa më lart, referuar punëve të ngjashme, të cilat i përkasin infrastruktures rrugore, asnjëra nga objektet e paraqitura nuk ploteson DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1, gërma “a” me vlerën 34,800,286 lekë pa TVSH. Gjithashtu referuar kontratave të vlefshme, rezulton se shumatorja e tyre është në vlerën 77,819,684 leke pa TVSH, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1, gërma “b”, ku shumatorja duhet të jete në vlerën 139,201,144 leke pa TVSH.

6. Operatori ekonomik “Kupa” shpk

NUIS K51615512C

- Operatori ekonomik nuk ka plotësuar kërkesat sipas shtojcës 8, formularit përmbledhës të vetdeklarimit pjesa II, deklarata A paragrafi I dytë ku specifikohet që operatori ekonomik *nuk është denuar për ndonjë nga veprimtari profesionale.....* pa plotësuar adresën ueb-it, organin leshues dhe llojin e dokumentit.
- Operatori ekonomik nuk ka plotësuar kërkesat sipas shtojcës 8, formularit përmbledhës të vetdeklarimit pjesa II, deklarata A paragrafi I tjetër ku specifikohet *që operatori ekonomik e ushtron aktivitetin e tij në zbatim të kërkesave ligjore në fuqi.....* pa plotësuar adresën ueb-it, organin leshues dhe llojin e dokumentit.
- Operatori ekonomik nuk ka plotësuar kërkesat sipas shtojcës 8, formularit përmbledhës të vetdeklarimit pjesa II, deklarata B paragrafi 1 ku specifikohet nën cilësinë e operatorit ekonomik..... pa plotësuar përgjigjen.

7. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Shendelli” shpk & “NG Structures” shpk

NUIS K07924803N & NUIS I79326502O

- Referuar Shtojcës 1, Formularit të ofertës ekonomike, rezulton se Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka ndryshuar volumet e punimeve përkatësisht:
 - Në kategorinë Punime sistemimi, zeri: *Mbjellje bari*, në Formularin e ofertës ekonomike sasia është 4,950 m², ndërsa në Preventivin e parashikuar nga AK sasia është 4,957.25 m²;
 - Në kategorinë Punime sistemimi zeri: *Pergatitje e vendosje lende e rrumbullakët (rrethim këndi i lojërave)*, në Formularin e ofertës ekonomike sasia është 12 m³, ndërsa në Preventivin e parashikuar nga AK sasia është 12,200 m³;
 - Në kategorinë Punime sistemimi zeri: *Koloncine metalike e fiksuar me bullona*, në Formularin e ofertës ekonomike sasia është 3 Ton, ndërsa në Preventivin e parashikuar nga AK sasia është 2,9 Ton;
 - Në kategorinë Sinjalistika zeri: *Boje termoplastike (sprajt) kembësore+stop*, në Formularin e ofertës ekonomike sasia është 73 m², ndërsa në Preventivin e parashikuar nga AK sasia është 74 m²;
 - Në kategorinë Punime KUB zeri: *FV tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=3154 mm*, në Formularin e ofertës ekonomike sasia është 1,182 ml, ndërsa në Preventivin e parashikuar nga AK sasia është 1,181 ml.
- Për sa më lart, Bashkimi i Operatorëve ekonomik, nuk ploteson DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 1, gërma “a”, pasi Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës nuk janë në përputhje me kërkesat e specifikuar në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit.

- Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka percaktuar ne Marreveshjen e Bashkepunimit se përqindja e pjesëmarrjes në punë do të jetë: 50 % e punimeve do te realizohen nga shoqeria “Shendelli” shpk dhe 50 % e punimeve do te realizohen nga shoqeria “NG Structures” shpk. Ne Marreveshjen e Bashkepunimit nuk eshte percaktuar se cili prej tyre do te permbushë Kapacitetin Teknik, pika 1, çka bie ne kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i percaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”*.

8. Operatori ekonomik “Albtiefbau” shpk **NUIS J66307049C**

- Operatori ekonomik nuk ka deklaruar tekniket e ndertimit dhe manovratorët ne formularin e vetedeklarimit.

9. Operatori ekonomik “Ina” shpk **NUIS J61814009W**

- Operatori ekonomik nuk ka plotësuar kerkesat sipas shtojces 8, formularit permbledhes te vetedeklarimit pjesa II, deklarata A paragrafi 2 dyte ku specifikohet qe operatori ekonomik *nuk eshte denuar per ndonje nga veprat penale.....* plotësuar gabim adresa ueb-it , organi leshues dhe lloji i dokumentit.
- Operatori ekonomik Ina shpk nuk ka plotësuar kerkesat sipas shtojces 8, formularit permbledhes te vetedeklarimit pjesa III, deklarata D “Perdisponimin e punonjesve te nevojshem per realizimin e punimeve object kontrate” paragrafi 2 ku specifikohet Personeli kryesor... nuk ka deklaruar Drejtuesit Teknik dhe Personin Pergjegjes Per Sigurine dhe Shendetin ne Pune”.

10. Operatori ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk **NUIS K02017003I**

- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Formularin e sigurimit të ofertës, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 1, gërma “b”.

11. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Sterkaj” shpk & “Arjeil” shpk
NUIS J68310708M & NUIS K31320002C

- Operatorëve ekonomik nuk ka plotësuar pikën 6, Kategoria B, Deklarata për dorëzimin e ofertave të pavarura të Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit (Shtojca 8), çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 1, gërma “c”.

12. Operatori ekonomik “Inerti” shpk **NUIS J66926804L**

- Operatori ekonomik nuk ka plotësuar Kategorinë B, pika 7 të formularit të vetedeklarimit (Shtojca 8) si dhe nuk ka deklaruar drejtuesin teknik në formularin e vetedeklarimit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “V.A.S. Konstruksion” shpk**, me adresë: *Rruga "Andon Zako Çajupi", Qendra Zayed Business Center, seksioni 3 C, D, kati III-të, Tiranë*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **48,987,046.50** (dyzetë e tetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyzetë e gjashtë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në Nenin 109 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.